



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:227105
Datë: 26.07.2024
Numri i dokumentit: 05985129

AC-I-23-0090

Në ankesën e

Paditësi

Z P nga fshati D Komuna e Klinës.

kundër

E paditura/ankuesja

NSH, "Mirusha" (në likuidim), të cilën e përfaqëson, Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rr. "Driton Hoxha", nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Imi Bajrami, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-0663 të datës 27 janar 2023, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 25 korrik 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1. Ankesa e të paditurës refuzohet si e pa bazuar.**
- 2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë i DHPGJS-së, C-IV-14-0663 i datës 27 janar 2023.**
- 3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Më 06 shkurt 2014, paditësi në Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJS), ka paraqitur ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PEJ068-0095 i dt. 23 dhjetor 2013, e me të cilin i është refuzuar si e pavlefshme kërkesa e paraqitur për kompensim për 6 (gjashtë) paga të pa paguara në shumën prej 1,559.00 për periudhën prej 01.11.2001 e deri me dt.30.04.2002 nga e NSH, "Mirusha" me seli në Klinë (në Likuidim). AL e kishte refuzuar kërkesën e paditësit për shkak të përshkrimit sipas nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Paditësi kësaj ankese ia ka bashkangjitur provat: vendimin e kundërshtuar të AL, kopjen e padisë së bërë me dt.15.10.2002 fillimisht pranë Gjykatës Komunale në Klinë dhe atë kundër të paditurës, NPTSH, "S" me seli në fshatin V, Klinë për kompensimin e të ardhurave personale dhe kontributeve për pension në shumë të përgjithshme prej 540,568.00 €, një kopje të kërkesës për kompensimin e të ardhurave personale drejtuar NSH Mirusha në Klinë, kopjen e njoftimit të datë 07 shkurt 2006 të AKP-së, drejtuar paditësit për shkëputjen e kontratës – përfundimin e punësimit në NSH, "Mirusha" me seli në Klinë dhe kopjen e listës së emrave të punëtorëve të NSH, "Mirusha" me seli në Klinë për shumën e pagave të tyre. Paditësi ka theksuar se ai ka iniciuar procedurë gjyqësore pranë Gjykatës Komunale në Klinë si dhe tek organet e ish AKM datë 27 dhjetor 2002, ndërsa kërkesa e parashtruar tek AL është refuzuar kinse mbi bazën e parashkrimit, i cili vendim është i pabazuar, i pa drejtë i papranueshëm dhe i diskriminues, duke e apeluar për shkelje qenësore të dispozitave procedurale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Paditësi pretendon se kërkesa nuk është parashkruar, dhe se AL me rastin e zbatimit të nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP, dhe Ligji të punës së Bashkuar gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, dhe se me rastin e vendosjes AL-ja, ka qenë dashur të zbatoj dispozitën nga neni 40.1.6.1 të Ligjit 04/L-034 për AKP, dhe propozon gjykatës që të miratohet kërkesa për rishikimin e vendimit të AL, të ndryshohet vendimi i AL, në kuptimin e njohjes së kompensimit të 6 pagave në lartësi të shumës 1559.00 euro, me kamat ligjore dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore, përfundimisht ti pranohen tri paga.

Me 27 dhjetor 2022, e paditura/ AKP ka parashtruar mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse e në të cilën ndër të tjera ka theksuar se me rastin e

vendosjes, Autoriteti i Likuidimit (AL), ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se parashtruesi nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore që e ka shkelur Autoriteti i Likuidimit (AL) e në kuptim të nenit 74 par.2 të Shtojcë së Ligjit nr.04/L -033, ankesa është e pabazuar. E paditura më tej thekson se pretendimet e parashtruesi janë të pabazuara dhe se kërkesa e parashtruesit është parashkruara sipas nenit 36.1 të Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP dhe nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, pasi nuk ka asnjë provë që parashtruesi të e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo organit tjetër kompetent, dhe i paraqet gjykatës të refuzoj si të pa pranueshme dhe të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e AL-së.

Me 27 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-0663, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, Z P të paraqitur kundër Vendimit PEJ068-0095 i dt.23.12.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe ka ndryshuar te njëjtin duke e obliguar të paditurën Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit, t'ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 779.49 euro në emër të 3 (tri) pagave të pa paguara, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 10 %, në shumë prej 77.94 €. Ndërsa ka refuzuar kërkesën tjetër të paditësit përtej shumës se aprovuar.

Shkalla e parë ka arsyetuar se ka shqyrtuar pretendimet dhe provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar NSH "Mirusha" në Klinë, ka hyrë në procedurë të likuidimit 16 shtator 2013, ndërsa parashtruesi ka parashtruar kërkesën tek AL për kompensimin e pagave të papaguara me datë 30 tetor 2013, për periudhën 01 nëntor 2001 - 30 prill 2002, që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurë të likuidimit tek AL-ja. Shkalla e para ka gjetur se nuk është kontestuese se në mes të palëve ndërgjyqëse ka qëndruar raportin juridik i marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe NSH "Mirusha" në Klinë të cilën tani e përfaqëson AKP, por kontestuese mbetet baza juridike e kërkesës të cilën e paditura ka konsideruar si të parashkruar, e të cilin pretendim e ka vënë në pah në Vendimin, PEJ068-0095 i datë 23 dhjetor 2013 të AL-së e me të cilin paditësit i është refuzuar si pa vlefshme kërkesa e tij.

Shkalla e parë ka konsideruar se AL-ja, gabimisht ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ nr.53 viti 1976), meqë nuk kemi të bëjmë me parashkrimin të kërkesës sipas vendimit të AL, andaj të njëjtin vendim gjykata e

anulon pjesërisht, si dhe duke aprovuar pjesërisht kërkesën e paditësit. Sipas padisë së datë 15 shkurt 2002, të paraqitur në Gjykatën Komunale në Klinë, paditësi - me punëtorët tjerë të kësaj NSH "Mirusha", në mënyrë grupore, kanë kërkuar kompensimin e përbashkët të pagave të tyre për periudhën kohore 01 nëntor 2001-30 prill 2002, si dhe me shkresën – kërkesën e datës 27 dhjetor 2002, të paraqitur pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, pagat e papaguara për 6 muaj, për të cilën nuk përkon me qëndrimin juridik të AL-së me rastin e refuzimit të kërkesës si të parashkruar dhe për të cilën ka cituar se nuk ka parashtruar kërkesën para ndonjë organi tjetër kompetent.

Shkalla e parë potencon se sikurse legjislacioni që ishte në fuqi para vitit 1998/99, ashtu edhe ligjet që janë miratuar pas viteve 1998/1999, e kanë ruajtur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit të kërkesave monetare nga lëmi i marrëdhënies së punës. Me Ligjin për Punën e Bashkuar (Gazeta Zyrtare nr. 53/76), neni 608 parashihej se *"pagesa e shumës së pagës apo rrogës, apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës, do të jetë e parashkruar për tri vite"*. Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i vitit 1978 (Ligj nr.690), neni 372.1 përcaktonte se *afati i parashkrimit të kërkesave periodike është tri vite, nga rrjedhja e secilës dhënie të veçantë për pagesë*. Ligji i Punës, i vitit 2010 (Ligj nr. 03/L-212), neni 87, përcakton se *të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*. Edhe LMD i ri, i vitit 2012 (Ligj nr. 04/L-077), neni 353.1, ka përcaktuar se *"Kërkesat e dhënieve periodike që rrjedhin vit për vit ose në afate të caktuara më të shkurtra (kërkesat periodike) ... parashkruhen tri (3) vjet nga arritja e secilës dhënie të veçantë për pagesë"*. Shkalla e parë ka vlerësuar se ushtrimi i padisë në mënyrë grupore nga ish punëtorët NSH, "Mirusha" me seli në Klinë, përfshirë edhe këtu paditësin, në Gjykatën Komunale në Klinë, i njëjti e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për pagat e pa paguara, prandaj qëndrimi i të paditurës se ka parashkrim të kërkesës së paditësit, është i pa bazuar. Neni 368 të paragrafi 1 i LMD-së, ku është paraparë se: *"Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës"*. Pagat e pa paguara që i takojnë periudhës kohore prej datë 01 nëntor 2001 e deri me datë 30 prill 2002, nuk është parashkruar e është çështje tjetër që vet paditësi, në padinë – ankesën e tij, e ka cekur se atij si ankues, t'i pranohen 3 paga të garantuara

ligjore të cilat do t'i caktoj gjykata sipas nenit 40.1.1.6.1 i Ligjit,nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP).

Shkalla e parë ka gjetur se sipas regjistrit të evidentuar të paraqitur në këtë gjykatë rrjedh se paditësi ka realizuar të ardhura mujore mesatarisht 259.83 euro, për të cilën në zbatim të dispozitave ligjore gjykata konsideron si të drejtë aprovimin e 3 (tri) pagave të pa paguara e në shumë të përgjithshme prej 779.49 euro, dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në që në mënyrë taksative, parashihet se: *"Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person"*. Vendimi i gjykatës për pjesën e kamatës ligjore, si kërkesë aksesore, është i bazuar në nenin 37 par.3 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme, e në të cilin është përcaktuar se: *"Të gjitha Kërkesat e bëra ndaj Ndërmarrjes mund të përfshijnë kamatë në çfarëdo shumë themelore të grumbulluar deri para datës së Vendimit të Likuidimit, me kusht që kjo kamatë të mos tejkalojë 10% (dhjetë për qind) të shumës themelore"*.

Me 13 shkurt 2023, e paditura / AKP e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-0663 të datës 27 janar 2023, me të cilën ka propozuar që të ndryshohet Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar në pajtim me nenin 9.10 të Ligjit 06/L-086 duke refuzuar ankesën ndaj Vendimit PEJ069-0095, të datës 23 dhjetor 2013 si të pa bazuar dhe te vërtetohet Vendimi i AL.

Në ankesën e parashtruar e paditura pranë Kolegjit të Apelit ka theksuar se duke u bazuar në Nenin 8 40.1.6.2 i shtojcës së Ligjit nr..04/L-034 i jetë të drejtë dëmshpërblimi vetëm atyre punëtorëve që janë pushuar nga puna si pasojë, e apo në lidhje me një veprim të ndërmarrë nga AKP-ja sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit nr. 04/L-034. Likuidimi është një veprim i paraparë me nenin 6.2 të Ligjit nr.04/L-034. Sipas nenit 40.1.6.2 i Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 rrjedhë se parashtruesi duhet te përmbushë dy kushtet e cekura aty për te përfituar të drejtën për dëmshpërblim për ndërprerje te parakohshme të kontratës së punës, më konkretisht (1) punëtori duhet të jete pushuar nga puna dhe (2) ky pushim duhet te këtë ardhur si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga AKP sipas nenit 6.1 apo 6.2 të ligjit nr.04//L-034. Tutje ka shtuar se është pikërisht për këtë arsye që

Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga të pa paguara të kontratës së punës për parashtruesin pasi që ky rezultoi të mos ishte aktiv në momentin kur filloi likuidimi-ky i fundit një veprim i ndërmarrë nga AKP sipas nenit 6.2. Rrjedhimisht duke qenë se nuk ishte aktivë me NSH-në, në momentin jur NSH-ja hyri në likuidim, nuk kishte se si marrëdhënia e tij e punës të ndërpritej nga një veprim i ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit nr.04/L034. E paditura ka theksuar se duke injoruar plotësisht parashtresën e palës kundërshtare dhe argumentet e saj në mbrojtje Aktgjykimi nuk përmbush aspak detyrimin e shprehur në nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme mbi nevojën e analizës së provave dhe parashtresave të prezantuara gjatë procedurës.

Me 11 mars 2024, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe i përgjigjet ankesës së të paditurës. Në këta parashtresë paditësi ka pohuar se pretendimet e të paditurës të paraqitura se kinse gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit, pas analizimit dhe vlerësimit dhe gjetjeve faktike ka bërë vlerësim të gabuar të situatës faktike, nuk qëndrojnë dhe janë të paargumentuara. Këto pretendime të palës së paditur, paditësi i konsideron si të pa bazuara të paargumentuara pastaj fiktive dhe si të tilla nuk mund të kenë ndonjë efekt në vendosjen meritore të rastit. Kjo për faktin ligjor se paditësi edhe përmes ankesës për rishikim të vendimit të AL kishte dorëzuar në gjykatë të gjitha faktet dhe provat që mbështesin kërkesëpadinë e tij kreditore. Me qëllim të vërtetimit të saktë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata pas bëri analizimin e fakteve dhe vlerësimit të provave të prezantuara nga pala paditëse ka ardhur në përfundim se faktet vendimtare të paraqitura nga pala paditëse janë jo kontestuese.

E paditura qëllimisht i keqinterpreton dispozitat e nenit 6.1 dhe 6.2 të ligjit 04/L-034, lidhur me nenin 40.1.6.2 të Shtojcës së Ligjit nr.04//L-034, pasi që paditësi i plotëson kushtet ligjore dhe ka drejtë në dëmshpërblim pasi që paditësi i është ndërprerë parakohë kontrata e punës, dhe ky pushim i marrëdhënies së punës është si pasojë e veprimit të ndërmarrë nga AKP-ja. Si provë ka bashkangjitur: shkresa e AKP-së mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditësit e datës 07 shkurt 2006. Në bazë të këtyre fakteve dhe provave vërtetohet se paditësi ishte punëtor aktiv të e paditura deri në momentin e fillimit të procedurës së likuidimit të ndërmarrjes kur edhe me veprimin e ndërmarrë nga e paditura të përmendurit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Andaj paditësi kërkon nga Kolegji i Apelit të DHPGJS që ankesën e të paditurës ta refuzojë si të pa bazuar, ndërsa Aktgjykimin C-IV.-14-0663 të datës 17 janar 2023 ta vërtetoi si të bazuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS, është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se kërkesa e paditësit për kompensimin e gjashtë pagave të papaguara në shumë prej 1,559.00 euro, për periudhën prej 1 nëntor 2001 deri më 30 prill 2002, ishte refuzuar si e pa vlefshme me vendimin e AL PEJ068-0095 të datës 23 dhjetor 2013, me arsyetimin se kërkesa e paditësit për paga të papaguara, është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Paditësi me ankesën e tij të dorëzuar në DHPGJS e kishte ankimuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit PEJ068-0095, të datës 23 dhjetor 2013, duke e konsideruar se kërkesa për paga nuk është parashkruar, dhe se AL me rastin e zbatimit të nenit 36.2 të Ligjit 04/L-034 për AKP, dhe Ligji të punës së Bashkuar gabimisht ka zbatuar dispozitat materiale, ashtu që kishte kërkuara që ti kompensohen pagat e papaguara.

Me 27 janar 2023, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-0663, e ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Vendimit PEJ068-0095 i dt.23.12.2013 të Autoritetit të Likuidimit (AL) dhe ka ndryshuar te njëjtin duke e obliguar të paditurën Agjencia Kosovare e Privatizimit që paditësit, t'ia

kompensoj shumën e përgjithshme prej 779.49 euro në emër të 3 (tri) pagave të pa paguara, sipas prioritetit të kërkesave, si dhe kamatën ligjore në lartësi prej 10 %, në shumë prej 77.94 €, ndërsa ka refuzuar kërkesën tjetër të paditësit përtej shumës së aprovuar.

Kolegji i Apelit vlerëson se Shkalla e parë me të drejtë kishte konstatuar se AL-ja, gabimisht ka zbatuar dispozitën materiale nga neni 36.2.1 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-034 për AKP lidhur me nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (GZ nr.53 viti 1976), meqë nuk kemi të bëjmë me parashkrimin të kërkesës për paga. Sipas padisë së datë 15 shkurt 2002, të paraqitur në Gjykatën Komunale në Klinë, paditësi - me punëtorët tjerë të kësaj NSH "Mirusha", në mënyrë grupore, kishin kërkuar kompensimin e përbashkët të pagave të tyre për periudhën kohore 01 nëntor 2001-30 prill 2002, si dhe me shkresën - kërkesën e datës 27 dhjetor 2002, të paraqitur pranë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Ushtrimi i padisë në mënyrë grupore nga ish punëtorët NSH, "Mirusha" me seli në Klinë, përfshirë edhe këtu paditësin, në Gjykatën Komunale në Klinë, e ka ndërprerë afatin e parashkrimit për pagat e pa paguara, prandaj qëndrimi i të paditurës se ka parashkrim të kërkesës së paditësit, është i pa bazuar. Neni 388 të paragrafi 1 i LMD-së, si ligj ne fuqi në atë kohë ka paraparë se: "*Parashkrimi ndërpritet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose një autoriteti tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës*". Andaj pagat e pa paguara që i takojnë periudhës kohore prej datë 01 nëntor 2001 e deri me datë 30 prill 2002, nuk është parashkruar.

Kolegji i Apelit po ashtu vlerëson se Shkalla e parë me të drejtë kishte konstatuar se sipas regjistrimit të evidentuar të paraqitur në këtë gjykatë rrjedh se paditësi ka realizuar të ardhura mujore mesatarisht 259.83 euro, për të cilën në zbatim të dispozitave ligjore e konsideron si të drejtë aprovimin e 3 (tri) pagave të pa paguara të paditësit në shumë të përgjithshme prej 779.49 euro, dhe se ky qëndrim i kësaj gjykate bazohet në dispozitat nga neni 40.1.1.6.1 i Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në që në mënyrë taksative, parashihet se: "*Kërkesat për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person*".

Andaj nga këto arsye që u tha me lartë Kolegji i Apelit nuk i mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit si dhe pretendimet e AKP-së të paraqitura në ankesë se kërkesa për paga është parashkruar.

Konstatimet lidhur me provat që i ka dhënë Shkalla e parë Kolegji i Apelit i konsiderohen si të sakta kur merret parasysh fakti se paditësi ka sjellë prova të mjaftuara në mbështetje të kërkesës së tij.

Andaj nga këto arsye, ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar, dhe vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 100 euro me datë 28 mars 2023, për procedurën ankimore andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 25 korrik 2024.

Mr.Sc Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
